

Prof. Dr. Ahmed Arslan

HYRJE NË FILOZOFI*

Ç'është filozofia? Vepra e njohur e Aristotelit *Metafizika* fillon me fjalinë “të gjithë njerëzit për nga natyra dëshirojnë të dinë”. Sërish sipas Aristotelit, kënaqësinë që e ndiejnë njerëzit gjatë përdorimit të shqisave të tyre, p.sh. gjatë shikimit, dëgjimit etj., është prova më e qartë për këtë. Vërtet veçoria më e rëndësishme që njeriun e bën njeri gjithsesi është dëshira e tij për ta njohur dhe mësuar botën që e rrethon, shoqërinë ku jeton, historinë dhe vetë vetveten me të gjitha aspektet e saj.

Tani, njohja është një lidhje midis qenies që njeh / di (në gjuhën e filozofisë -subjektit) dhe qenies që dëshirohet të njihet ose që është njohur që më parë (në gjuhën e filozofisë – objektit). Çështjet që kanë të bëjnë me atë se cila prej këtyre elementeve të kësaj lidhjeje peshon më shumë, ai që njeh apo ajo që njihet; mundësia apo pamundësia e njohjes; burimi, shtrirja, hapësira, kufijtë e njohjes etj., përbëjnë lëndën e veçantë të degës së filozofisë të quajtur *teoria e njohjes* apo *epistemologjia*.

Edhe filozofia, në fakt, është një lloj njohje, mirëpo është një lloj njohjeje e veçantë. Për të kuptuar se ç'lloj njohjeje është filozofia, cilat janë karakteristikat e njohjes filozofike, duhet të flasim edhe për llojet e tjera kryesore të njohjes. Ne këtu do ta trajtojmë *njohjen e thjeshtë / opinionin* dhe *njohjen shkencore*.

Njohja e thjeshtë / opinionin: Lloji më i përhapur i njohjes dhe të cilën të gjithë ne pak a shumë e zotërojmë është njohja e thjeshtë, opinionin. Njohja e thjeshtë, ashtu siç tregon edhe vetë emri i saj, nënkupton njohjen e rëndomtë të cilën njerëzit e fitojnë në jetën e tyre të përditshme pas disa provave më të thjeshta. Burimi i kësaj njohjeje është struktura e përbashkët biologjike e të gjithë njerëzve dhe përngjashmëria e rrethanave shoqërore në të cilat ata jetojnë. P. sh., qoftë gjeni, qoftë një njeri i thjeshtë, të gjithë e dinë se shiu lag, se zjarri djeg; të kuqen e quan të kuqe, sendet e nxehta i quan të nxehta etj. Po kështu, në saje të një njohjeje të këtillë njeriu thotë se “të ushqyerit e largon urinë”, se “pas pranverës vjen vera” etj. Ky lloj njohjeje nuk është fituar si rezultat i një metode të vetëdijshme kërkimi, porse fitohet pashmangshëm dhe pa qenë i vetëdijshëm për të, ndaj dhe nga aspekti struktural është i pasistemuar. Ajo paraqitet si rezultat i të jetuarit, i përdorimit të shqisave dhe eksperimenteve të llojit më të thjeshtë dhe nuk mbështetet në ndonjë metodë të vetëdijshme.

Dy shembuj të njohjes që e tejkalojnë atë të thjeshtën / opinionin duke përdorë metoda të vetëdijshme janë: **njohja shkencore** dhe **njohja filozofike**. Lëndët, si: karakteristikat e njohjes shkencore, shkenca, metodat shkencore, kërkimi shkencor, sqarimi shkencor, teoria shkencore, ligjet shkencore etj. do t'i trajtojmë në pjesën e tretë të këtij libri. Prandaj këtu do të mjaftohemi

* Kapitulli i parë i librit *Felsefeye Giriş (Hyrje në filozofi)*, Vadi Yayınları, Ankara, 1994.

vetëm me shënimin se njohja shkencore, për dallim prej njohjes së thjeshtë, është lloji më i besueshëm i njohjes sepse mund të bëhet verifikimi i saj përmes metodave shkencore.

Njohja filozofike: Është shumë më vështirë të përcaktohet njohja filozofike. Për më tepër, mund të thuhet se problemi më i rëndësishëm që ka të bëjë me filozofinë është vetë problemi se ç'është në të vërtetë filozofia. Hapi më i drejtë që duhet hedhur gjatë përpjekjeve për ta kuptuar njohjen filozofike apo filozofinë është të shikohet **vetë puna që e kanë bërë** njerëzit e quajtur filozofë përgjatë historisë. Kur t'i qasemi kësaj çështjeje nga ky këndvështrim, do të shohim se filozofët në kohë të ndryshme, në kultura të ndryshme, me qëllime të ndryshme dhe me funksione të ndryshme kanë prodhuar filozofi të ndryshme konkrete. Përkundër kësaj, në vetë punën që e kanë bërë këta njerëz të cilët kanë jetuar në kohë të ndryshme dhe kanë prodhuar filozofi të ndryshme me qëllime të ndryshme, sërish do të vërejmë se në to ka **disa veçori të përbashkëta**.

Kanti (Immanuel Kant) filozofinë e ka përkufizuar si **“një formë e angazhimit intelektual që pretendon ta legjitimojë vetveten me arsye racionale”**. Sipas nesh, ky përkufizim shumë bukur e shtron një pikë e cila filozofinë e bën filozofi dhe e cila është e përbashkët për të gjithë shembujt e të menduarit filozofik. Këtu, prej fjalisë “me arsye racionale”, duhet nënkuptuar një grup arsyesh që në vete ngërthejnë çdo lloj eksperimenti, vrojtimi dhe çdo lloj rezonimi e intuited që mbështeten në ato të parat. Prej pretendimit “për legjitimim” duhet nënkuptuar “parashtrimin e çfarëdo një gjykimi (premise) përmes argumenteve, mbështetjeve dhe arsyetimeve të cilat e mundësojnë shtrimin e një gjykimi të tillë”. P.sh., meqë të gjithë njerëzit janë të vdekshëm dhe meqë edhe Ahmeti është një njeri, atëherë domosdo duhet të pranojmë se edhe Ahmeti është i vdekshëm. Këtu, këto dy premisa e bëjnë të domosdoshëm dhe të pashmangshëm parashtrimin e këtij përfundimi. Natyrisht, këtu me rëndësi është mënyra se si i kemi fituar dy premiset e para. Filozofia kërkon që edhe këto dy premisa të fitohen ose a) si konkluzion (përfundim) i një rezonimi (arsyetimi) tjetër si ky i pari, ose b) si rezultat i eksperimentit, vrojtimit dhe përsiatjes së vetëdijshme rreth tyre ose edhe i përzierjes së intuitës në këtë veprim ashtu siç përmendëm më lart.

Në filozofi, me rëndësi nuk janë përfundimet filozofike, por mënyra se si arrijmë tek ato. Ndryshe thënë, në filozofi nuk bëhet fjalë për do përfundime që mund të pranohen nga të gjithë, ashtu siç është rasti te shkencat. Për më tepër, mund të thuhet se çdo filozof mundohet të krijojë një sistem të ri filozofik duke e kritikuar zhvillimin apo pretendimet e filozofisë deri në kohën e tij. Filozofia nënkupton, jo arritjen e një synimi apo përfundimi, por, ashtu siç thotë Karl Jaspersi, ‘të qenët gjithmonë në rrugë’. Në këtë kontekst mund të thuhet se në filozofi, sa është e rëndësishme gjetja e një përgjigjeje të re për problemin më të thjeshtë filozofik, po aq e rëndësishme është edhe hedhja në shesh e një problemi të ri dhe të mirëfilltë. Bile për disa filozofë rasti i dytë është më i rëndësishëm se i pari. Po kështu, në filozofi është shumë e rëndësishme futja e disa fushave të qenies në fushën e të menduarit filozofik, të cilat më parë kanë qenë jashtë saj. P. sh., në historinë e filozofisë greke, trajtimi dhe shqyrtimi nga aspekti filozofik i temave lidhur me kulturën, etikën dhe politikën nga ana e sofistëve dhe e Sokratit që deri më atëherë nuk ishin trajtuar si të tilla, në historinë e filozofisë në përgjithësi quhet si një përparim tej të rëndësishëm.

Veçoritë e mendimit filozofik: Krahas kësaj që u tha deri më tani, lidhur me veçoritë e mendimit filozofik mund të tërheqim vëmendjen edhe në këto pika: Mendimi filozofik është një mendim kritikues; pra, çdo lloj materiali që e merr për vete si të dhënë e kalon përmes sitës kritikuese të

mendjes (arsyes, racios). Ky material, sikur mund të përfitohet drejtpërdrejtë nga ana e fushës së ekzistencës (qenies) së cilës i është drejtuar, ashtu mund të përfitohet edhe nga veprimtari të tjera intelektuale lidhur me këto fusha të qenies. P. sh., sikur mund një filozof të mendojë nga një aspekt kritik drejtpërdrejt për natyrën, historinë, shoqërinë etj., ashtu mund të mendojë edhe për materialet e dhëna nga shkenca të ndryshme lidhur me këto lëmi; mund të hulumtojë shkallët e vlefshmërisë dhe kufijtë e tyre etj. Për këtë veçori të fundit thuhet se filozofia është **njohje e njohjes** ose **një aktivitet i të menduarit reflektiv**. Një veçori tjetër e mendimit filozofik është se ai përdor nocionet dhe abstraksionet që i ka të përbashkëta me ato të mendimit shkencor dhe me ndihmën e tyre sugjeron parime e ligje. Këtë mund ta quajmë si karakteristikë përgjithësuese që dëshiron të arrijë në konkluzione të përbashkëta. Kështu, përkundër shkencës e cila merret me nocione të përgjithshme dhe abstrakte si: *çmimi, mundi, kërkesa, prona, energjia, shpejtësia, pesha specifike* etj., filozofia punon me nocionet, si: *prova, njohja, kuptimi, vërtetësia, synimi, Zoti, intelekti, natyra* etj. Këtu ekziston një dallim midis shkencës, më mirë thënë midis shkencave dhe filozofisë në kuptimin se e para përdor disa nocione që kanë të bëjnë me fusha të ndryshme e të veçanta të qenies, ndërkaq e dyta përdor një sërë nocionesh më të përgjithshme. Sidomos kjo vlen sa i përket një dege të filozofisë të quajtur **metafizikë**, e cila për lëndë studimi ka atë që tradicionalisht quhet “shkenca e të qenët si e qenë”, gjegjësisht studimi i karaktereve të përgjithshme që paraqiten në çdo fushë hulumtimi, si dhe që përfshinë analizën e nocioneve që shprehin *materien, formën, mundësinë, ligjin, procesin, formimin / gjenezën, arsyen, veprën, strukturën* etj.

Funksioni analitik dhe sintetik i filozofisë: Një veçori tjetër e mendimit filozofik është funksioni i tij zbërthyes (analitik) dhe përmbledhës (sintetik). Kur themi funksioni analitik i mendimit filozofik nënkuptojmë, ashtu siç u përmend edhe më lart, rishqyrtimin, zbërthimin dhe ndriçimin e sërishëm të materialit të formuar në bazë të çdo lloji njohjeje, eksperimenti, perceptimi dhe intuïte që i është parashtruar filozofit me rastin e përpjekjes së tij për ta kuptuar botën ku bën pjesë edhe vetë ai, sipas aftësive të njohjes, të eksperimentimit, të perceptimit dhe të intuïtës së vetë filozofit. Mirëpo, filozofi nuk mjaftohet vetëm me këtë, ai nuk e lë botën të shpërndarë e të copëtuar në këtë formë; por, paralelisht me këtë, duke u nisur nga materiali apo të dhënat për të cilat ka menduar, i ka zbërthyer dhe i ka ndriçuar më parë, ai sërish e krijon botën, e formon dhe ia jep tërësinë dhe unitetin që duhet ta ketë. Këtij veprimi i thuhet funksioni sintetik apo sistemues i filozofisë. Kështu, filozofët si: Platoni, Aristoteli, Ibni Sinai, Hegeli etj. janë filozofë sistemues të cilët sipas mendjes së tyre botën e rikrijojnë si një strukturë e cila shpreh tërësinë të përbërë prej të gjitha pjesëve të harmonizuara mes vete.

Filozofia dhe vlerat; Filozofia si dashuri ndaj urtësisë: Një veçori tjetër më e rëndësishme që e dallon mendimin filozofik prej shkencës është se, përkundër asaj që shkenca merret vetëm me faktet, filozofia, nga ana tjetër, përsëri fakteve lëndë studimi ka edhe një lloji qenieje apo një fushë ekzistimi që përfshinë tërësinë e **vlerave, kuptimeve, idealeve** apo **synimeve**. Termi *filozofi*, siç dihet, është trajta e ndërkombëtarizuar e termit *philosophia* që në gjuhën greke nënkupton “dashurinë ndaj urtësisë / mençurisë”. Tani, ashtu siç tregon kuptimi burimor i fjalës, filozofia nuk është dashuri ndaj **njohjes** (greqisht *episteme*), por ndaj **urtësisë** (arabisht *el-hikmeh*). Urtësia apo *hikmeti*, për dallim prej njohjes është një nocion shumë më pretendues dhe më i pasur. Urtësia, më thjeshtë thënë, është njohuri e thellë lidhur me kuptimin dhe vlerën e jetës së njeriut. Urtësia është njohje e kuptimshme dhe e vlefshme që supozohet se zotëruesit të saj mund t’i sigurojë lumturinë dhe shpëtimin, se jetës mund t’i japë kuptimin dhe vlerën. P.sh., ligji

universal i tërheqjes (gravitacionit) që sipas Newtonit (Njutonit) nënkupton se çdo trup tërheq trupin tjetër me forcën që është proporcionale me produktin e masave të tyre, dhe anasjelltas proporcionale me katrorin e largësisë së tyre reciproke, është një njohje që ka të bëjë me **faktin** dhe që duhet të trajtohet nga shkenca e fizikës apo astronomisë. Mirëpo, nëse kjo njohje, nga vetë Newtoni apo nga dikush tjetër, interpretohet si një shenjë, si një *ajet* që lajmëron për vulën e vënë në qeniet nga ana e një Zoti të mençur i cili gjithësinë e ka krijuar në një formë matematikore dhe sipas një plani të caktuar, atëherë kjo është më tepër se njohje, është një urtësi. Urtësia është njohje për hir të së cilës Sokrati e ka marrë në sy vdekjen. Po kështu, urtësi është njohja për të cilën Kur'ani na thërret që duke e kundruar gjithësinë të mendojmë për krijuesin e saj.

Filozofia e vlerave: Prej këtu shfaqet burimi dhe arsyeja e ekzistimit të disiplinës së filozofisë e quajtur “filozofi e vlerave” (*aksiologji*), e cila kryesisht merret me vlerat të cilat nuk i trajton shkenca, siç është **e mira** ose **e keqja**, **e bukura** ose **e shëmtuara** etj. Ashtu siç është e njohur, dy nocionet e para të këtij çifti janë lëndë e posaçme e “filozofisë së moralit” (*etikës*), kurse dy të fundit janë të “filozofisë së artit” (*estetikës*). Për më tepër, duke e marrë në konsideratë vërejtjen me vend të Aristotelit, mund që, disiplinën e cila “të mirën dhe të keqen” e trajton në planin individual, ta quajmë “filozofi të moralit”, kurse disiplinën e cila “të mirën dhe të keqen” i trajton në planin shoqëror, në planin e regjimit politik, pra e trajton administrimin e mirë apo të keq, ta quajmë “filozofi politike”. Ka edhe mendimtarë që mendojnë se ekziston mundësia që logjikën apo filozofinë e shkencës t’i quajmë edhe si nga një lloj discipline të filozofisë së vlerave, ngase, jo nga aspekti moral, por nga ai shkencor-faktik “të drejtën dhe të gabueshmen” i trajtojnë si nga një **normë**. Po kështu, nga i njëjti këndvështrim, edhe “filozofinë e religjionit” mund ta llogarisim si një lloj discipline të filozofisë së vlerave, e cila “fenë” e trajton si një vlerë, dhe bashkë me këtë edhe nocionet themelore të fesë, si: Zotin, njeriun, ibadetin (adhurimin), mëkatin, sevabin (shpërblimin), shpëtimin etj. i bën lëndë diskutimi filozofik dhe vlerësues. Këtu nuk mund t’i radhisim, p.sh., disiplinat shkencore si, të “historisë së feve”, të “studimeve komparative të religjioneve” etj., të cilat “fenë” e trajtojnë vetëm si një fakt që haset në shoqëri, e jo edhe si një vlerë.

Disiplinat kryesore të filozofisë: Me këtë që thamë më lart, njëkohësisht i numëruam edhe disiplinat kryesore të filozofisë bashkë me fushat dhe problemet e interesimit të tyre. Këto janë: “teoria apo filozofia e njohjes / epistemologjia / gnoseologjia”, “filozofia e shkencës”, “filozofia e qenies / ontologjia”, pastaj vijnë disiplinat për të cilat thamë se duhen numëruar si degë të filozofisë së vlerave e që janë: “filozofia e moralit / etika”, “filozofia e politikës”, “filozofia e artit / estetika” dhe së fundi “filozofia e fesë”.

Relacioni filozofi – shkencë: Ashtu siç u përmend edhe më lart, filozofia i ndanë këto veçori të përbashkëta me shkencën: a) të dyja, përgjithësisht, flasin në emër të arsyes / racios dhe tentojnë ta legjitimojnë veten me arsye racionale, b) të dyja përbëjnë nga një aktivitet hulumtimi të vetëdijshëm, metodologjik dhe sistematik, c) të dyja dëshirojnë të arrijnë te parimet dhe ligjet duke përdorur nocione dhe abstraksione, pra bëjnë përgjithësime.

Nga ana tjetër, dallimet midis tyre mund t’i radhisim si më poshtë: a) Nocionet dhe abstraksionet e shkencës janë më pak të përgjithshme se të filozofisë dhe për lëndë studimi kanë lëmi më të posaçme, b) Derisa filozofia merret edhe me faktet edhe me vlerat, shkenca interesohet vetëm për faktet apo edhe për vlerat si fakte (siç janë shkencat humane apo ato shoqërore); vlerat, kuptimet,

idealet, synimet...si të tilla nuk mund të bëhen lëndë të studimit shkencor. Më thjesht thënë, fakteve që i trajton shkenca, nuk mund t'u japë gjykime vlerësuese dhe t'i quajë *të mira, të këqija, të drejta, të gabueshme, të vërteta, të rrejshme* etj. apo edhe t'i ngarkojë me synime, ideale dhe kuptime, c) Derisa gjykimet (premisat) shkencore mund të verifikohen, ato filozofike, në kuptimin e ngushtë, nuk mund të verifikohen. Derisa mund të japim parashikime duke u mbështetur në shkencë dhe në llogaritje e stërllogaritje, këtë në filozofi nuk mund ta bëjmë, d) Derisa metodat dhe teknikat e hulumtimit dhe të zbulimit shkencor janë të njohura dhe mund të mësohen, në filozofi nuk ekziston ndonjë metodë hulumtimi dhe arsyetimi e qartë dhe standarde për të cilën do të kishin rënë në ujdi edhe vetë filozofët. Nëse mund të thuhet, secili filozof ka nga një metodë filozofimi të veçantë, që është karakteristike për secilin prej tyre, e) Derisa duke u mbështetur në shkencë mund të krijohen teknologji, që nënkuptojnë zbatimin e shkencës në praktikë, në filozofi, së këndejmi, nuk është e mundshme një gjë e këtillë. Filozofia është një proces **arsyetimi** (*nadhar, theoria*) dhe **veprimi** (*amel, praksis*), e nuk është proces **bërjeje, formimi** (*san'at, tekhne*). Për këtë arsye, prej filozofisë nuk mund të lindë **teknika, teknologjia, arti, industria** etj., ashtu siç ndodh te shkenca.

Përkundër kësaj, shkenca ka qenë ajo që, gjatë historisë, më së tepërmi ka bashkëpunuar dhe ka pasur ndikim të ndërsjellë (reciprok) me filozofinë. Meqë filozofia, para së gjithash, ka për qëllim ta njohë dhe ta dijë si vetë njeriun, ashtu edhe botën, shoqërinë që e rrethon atë, është e pamundshme të jetë e paimformuar për rezultatet e kërkimeve shkencore që kanë të bëjnë me të gjitha këto lëmi. Nga ana tjetër, meqë edhe shkenca ka për qëllim njohjen e vërtetë e të drejtë, atëherë ajo nuk mund të rrijë indiferente ndaj rezultateve të kërkimeve filozofike të cilat mund ta orientojnë, ta kritikojnë e ta vetëdijësojnë atë sa i përket mundësisë, kushteve, burimeve dhe kufijve të njohjes së drejtë. Mirëpo, edhe përkundër kësaj, **filozofia nuk është shkencë**. Në filozofi ndjehet nevoja për një “inteligjencë kreative”, akumulim njohurish, intuitë dhe ndjenjë në shkallë më të madhe sesa në shkencë.

Relacioni filozofi – fe: Sqarime më të hollësishme lidhur me fenë dhe me veçoritë e njohjes fetare do të japim më vonë. Këtu mjafton vetëm të përmendim se ekzistojnë dallime të mëdha midis njohjes që mund të quhet fetare dhe asaj shkencore apo filozofike, si për nga burimet, ashtu edhe për nga synimet dhe strukturat e tyre. Nëse shikohet më thellë, mund të thuhet bile se në fe nuk ekziston një lloj njohjeje si ajo që haset në shkencë apo në filozofi. Feja është “një përpjekje që jetën e njeriut ta fusë në një relacion të kënaqshëm dhe kuptimplotë me gjithësinë në të cilën ndodhet njeriu si dhe është një tentativë për të siguruar urtësinë në administrimin e punëve të njeriut”. Mirëpo, feja këtë mundohet ta realizojë më tepër në planin praktik dhe ndijor / sentimental, sesa në atë intelektual. Më thjesht thënë, feja më tepër e mbulon nevojën e njeriut për të **besuar** në botën, në parimin që e administron botën – Zotin, në mendimin se jeta e njeriut ka një kuptim, sesa nevojën e tij për ta njohur botën. Ndërkaq ekziston një dallim më se i qartë midis besimit dhe njohjes: nuk i besohet një gjëje që njihet, sepse ajo vetëm njihet. Nga ana tjetër, nuk njihet një gjë së cilës i besohet, më mirë thënë, nuk është nevoja të njihet apo nuk ndjehet nevoja që ajo të verifikohet apo të përgënjeshtrohet me ndonjë njohje. Fetë nuk kërkojnë “njohje” prej ithtarëve të tyre, sepse ato zaten pretendojnë që “njohjen” atyre ua sjellin vetë këto (fetë). Atë që ato e kërkojnë prej ithtarëve të tyre është t'u besojnë njohjeve që i kanë dhënë dhe mesazheve që i kanë sjellë. Tekefundit, zaten edhe vetë vlera e besimit (*imanit*) qëndron këtu. Sikur njohja ta zinte vendin e besimit, apo sikur gjëja që besohet njëkohësisht të ishte e mundshme që për nga struktura të njihej, atëherë nuk do të kishte nevojë për fenë, pas pak kohësh vendin e besimit do ta zinte njohja. Besimi nuk është një angazhim intelektual apo vërtetim shpirtëror që përvetësohet për një kohë të shkurtër për shkak të mungesës së njohurive lidhur me

një send, një qenie apo me një vlerë dhe që braktiset menjëherë sapo të lindë mundësia për arritjen e njohurive të prera e të besueshme lidhur me to. Përkundrazi, është një angazhim intelektual apo një vërtetim shpirtëror (i vullnetshëm) origjinal lidhur me një send, një qenie, një vlerë, që përvetësohet pavarësisht prej njohjes dhe që nuk mund të zëvendësohet me çfarëdo një anti-njohje, sepse i takon një plani të veçantë të shpirtit të njeriut. Përfundimi më i rëndësishëm që del prej këtij konstatimi është se midis besimit të një sendi dhe njohjes së tij gjithmonë do të ketë një ndarje dhe zbrazëti që kurrë nuk do të mbushet. Përkundër kësaj, është fakt se fetë përdorin shprehje që duken se bartin një vlerë njohjeje lidhur me konceptet dhe vlerat themelore dhe se herë pas here prej nesh sikur kërkojnë t'i "njohim" ato. Mënyrën se si do të duhej të interpretoheshin këto, do të mundohemi ta parashtrojmë në pjesën ku do të diskutojmë për filozofinë e fesë.

Relacioni filozofi – art: A thua na kumton gjë arti apo artisti kur i shpreh ndjenjat dhe mendimet e tij në mënyrën që çdokush do të mund ta kuptonte? Me fjalë të tjera, ç'lloj njohjeje është ajo që na shtron artisti, më mirë thënë, a është ajo një njohje? Vepra artistike, për dallim prej shkencës po bile edhe prej filozofisë, ne nuk na kumton asgjë që ka të bëjë me botën e cila perceptohet në mënyrë normale, apo me botën objektive. Në të, sërish përkundër shkencës dhe filozofisë, nuk mund të parashtrohet asnjë **dukuri** apo **ligj**, dhe sërish asnjë gjë nuk mund të quhet **e drejtë** apo **e shtrembër**. Arti, ne na tregon botën e artistit, **të vërtetën** e tij. Kjo “e vërtetë”, gjithsesi, nuk është **objektive** apo **universale**, ashtu siç nënkuptohet në shkencë dhe në filozofi. Kjo është një e vërtetë **subjektive** dhe **personale**. Nga ana tjetër, qëllimi kryesor i artistit zaten nuk është të na thotë ne diçka, por të na **sugjerojë / inspirojë** një gjë apo të na **zgjojë** një send, sidomos një ndjenjë, një emocion. Prandaj dhe gjuha e tij, bile edhe në momentet kur më së tepërmi i afrohet gjuhës së shkencës apo të filozofisë, nuk është një gjuhë normale ashtu siç e njohim ne, është një gjuhë e veçantë. Edhe kuptimi i saj nuk është **logjik**, por është **poetik**. Përkaj kësaj, është e vërtetë se një sistem filozofik i kurdisur mirë, te ne mund të zgjojë një ndjenjë apo një emocion estetik sa edhe një roman apo poezi e thurur mirë.

Dobitë e filozofisë: Dhe së fundi dëshirojmë të themi disa fjalë lidhur edhe me dobitë apo nevojën e filozofisë, lidhur me funksionin e saj shoqëror-kulturor dhe me zhvillimin e saj historik. Kur vëllezërit Mongolfier vendosën të bënin fluturimin e parë me balonën që e kishin shpikur, njëri prej spektatorëve që ishin mbledhur në shesh për të ndjekur demonstrimin, i drejtohet një zotëriu të vjetër, të respektueshëm dhe simpatik, me pyetjen: “Mirë, ama ç’dobi kemi prej kësaj?”. Zotëriu në moshë – që ishte Benjamin Franklioni, dijetari dhe politikani i njohur amerikan, i cili kësokohe ndodhej për vizitë në Francë – i përgjigjet me të njëjtin stil dhe duke buzëqeshur: “Ç’dobi kemi prej foshnjës së porsalindur, zotëri?”.

Sipas mendimit tonë, kjo është përgjigja më e bukur dhe më kuptimplote që mund t'i jepet pyetjes se ç'na duhet filozofia dhe përgjithësisht çdo një aktivitet tjetër kulturor. Nëse i qasemi problemit vetëm nga këndvështrimi pragmatik, se “ç'na duhet”, atëherë shumë disa aktivitete tonat për të cilat mendohet se vlejné për diçka, si p.sh. shkenca bile, shpesh nuk vlejné gjë. Sepse, është e vërtetë se shkenca e mjekësisë në saje të së cilës i shërojmë sëmundjet, i zbusim dhimbjet tona, nga ky aspekt është e dobishme dhe na shërben për ruajtjen e shëndetit. Mirëpo, ç'na duhet të dimë prej se është formuar gjithësia, cilat galaksi në ç'vend të hapësirës ndodhen, përse janë shfarosur dinozaurët që kanë jetuar dikur? Ndoshta shkenca e aritmetikës na shërben për të ditur sa do të duhet të paguajmë gjatë shitblerjes, sa fitim do të kemi me rastin e rënies së çmimeve etj.; mirëpo, ç'do të na hyjë në punë të dimë ato diskutimet gjeometrike të zhvilluara me shekuj të

tërë lidhur me problemin nëse mund apo jo të vizatohet më tepër se një paralele në hapësirë prej një pike kah një vijë e drejtë? Shembujt mund t'i shtojmë, por s'e shohim të nevojshme. Është e vërtetë se herë-herë shkenca na hyn në punë. Mirëpo një shkencëtar apo shumica e shkencëtarëve, kur merren me një studim as që pyesin nëse kjo do t'i vyejë apo jo...Qëllimi i tij është, ashtu siç thoshte Aristoteli, ta kënaqë “dëshirën e natyrshme të njeriut për të ditur”. Po kështu, po të themi se arti apo një vepër artistike na siguron ndonjë dobi, kjo do të thotë mohim i arsyes së ekzistimit të artit si të tillë. Arsyeja sqaruese e një karrigeje që e përdorim në shtëpi, është sjellja e një dobie që sigurohet përmes mundësisë për t'u ulur në të. Edhe një varëse ku e varim xhaketen na shërben për moszhbravitjen e saj. Mirëpo, nëse vetë karrigia është në stilin e Louisit XVI, apo nëse varësja është prodhim i një skulptori të famshëm, atëherë nuk është e mundshme të sigurojnë ndonjë dobi si në rastet e para. Në këto dy rastet e fundit kemi të bëjmë me një vlerë që është jashtë çdo dobie dhe që është e pavarur prej saj, pra është një vlerë që ka të bëjë me “të bukurën”, me “emocionuesen dhe kënaqësisjellësen nga aspekti estetik”. Ta marrim moralin: Le që na vyen apo nuk na vyen gjë, por është e vërtetë historike se, ashtu siç ka ndodhur me disa njerëz të lartë që kanë treguar sjellje morale (p.sh. Sokrati, Muhammedi, Isai, Buda), njerëzit që kanë manifestuar sjellje të këtilla gjithnjë janë ballafaquar me vështirësi, vuajtje, shqetësime po bile edhe me vdekje. E pra është e qartë se sjelljet morale nuk i sjellin njeriut ndonjë dobi, kënaqësi në kuptimin e përditshëm të fjalës. Përfundimisht edhe filozofia, ngjashëm si me të gjitha këto, për nga esenca dhe nga ky pikëvështrim nuk sjell ndonjë dobi, megjithëse lirisht mund të themi se është shumë e dobishme për njeriun të mundohet ta njohë e ta mësojë gjithësinë që e rrethon, jetën nëse ajo ka apo jo ndonjë qëllim, natyrën e fatit të tij, sa mund të ndikojnë veprat e njeriut në ndryshimin e fatit të tij, brenda kufijve të zgjedhjes së tij pas cilave vepra e sjellje duhet të vrapojë, cili lloj i jetës mund të jetë më i miri si nga aspekti individual ashtu edhe nga ai kolektiv etj. S'ka mëdyshje se hulumtimi filozofik, ashtu siç thamë edhe më parë, ka dobitë e veta nga disa aspekte të tjera. P.sh., mund t'u ndihmojë shkencave, u ka ndihmuar feve etj...Mirëpo, motivi kryesor që qëndron pas kësaj është ai që më së miri e ka shprehur Sokrati në fjalët e tij: “Nuk meriton të jetohet një jetë e pahulumtuar, e paanalizuar dhe e pamenduar”. Njeriu është **aftësi që e studion jetën e vet**. Pa këtë ai është një hiç, një asgjë. Filozofia është shprehja më e plotë e shpirtit hulumtues i cili njeriun e bën njeri dhe i cili e shpëton atë prej hiçit, është shprehje e aktivitetit të kuptimdhënies, interpretimit dhe vlerësimit, është shprehje e parashtrimit të pyetjeve të rëndësishme dhe e përgjigjeve të tyre serioze, është shprehje e të qenët i virtytshëm dhe i lumtur, shkurt thënë, është shprehje e mallit për arritjen e urtësisë.

Nga turqishtja:
mr. Rejhan Neziri